

31991R3925

Rregullorja e Këshillit nr. 3925/91 (KEE) e 19 dhjetorit 1991 lidhur me heqjen e kontrolleve dhe formaliteteve që zbatohen për bagazhet e dorës dhe bagazhet e regjistruara të personave që kryejnë fluturime brenda Komunitetit si edhe për bagazhet e personave që kryejnë kalim detar brenda Komunitetit

Gazeta Zyrtare L 374, 31/12/1991 Fq. 0004-0006

Botimi i veçantë finlandez: Kapitulli 7 Volumi 4 qF. 0064

Botimi i veçantë suedez: Kapitulli 7 Volumi 4 Fq. 0064

RREGULLORJA E KËSHILLIT . 3925/91 (KEE) e 19 dhjetorit 1991, lidhur me heqjen e kontrolleve dhe formaliteteve që zbatohen për bagazhet e dorës dhe bagazhet e regjistruara të personave që kryejnë fluturime brenda Komunitetit si edhe për bagazhet e personave që kryejnë kalim detar brenda Komunitetit

KËSHILLI I KOMUNITETEVE EVROPIANE;

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Ekonomik Evropian dhe në veçanti nenin 100 (a) të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit (1),

Në bashkëpunim me Parlamentin Evropian (2),

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit Ekonomik dhe Social (3),

Duke pasur parasysh se në bazë të nenit 8 (a) të Traktatit, tregu i përbashkët nënkupton një hapësirë pa kufij të brendshëm, në të cilën garantohet veçanërisht lëvizja e lirë e mallrave; duke pasur parasysh se në një kontekst të tillë, aeroportet dhe portet detare marrin një rëndësi të veçantë, sepse përfaqësojnë njëkohësisht kufij të jashtëm dhe të brendshëm; duke pasur parasysh se zbatimi i parimit të lëvizjes së lirë, duhet gjithsesi të eliminojnë kontrollet e bagazheve të dorës dhe të bagazheve të regjistruara të personave që kryejnë fluturime brenda Komunitetit si edhe të bagazheve të personave që kryejnë një kalim detar brenda Komunitetit;

Duke pasur parasysh se udhëtimet ajrore mund të përfshijnë një seri fluturimesh brenda Komunitetit dhe disa jashtë këtij të fundit; duke pasur parasysh se për fluturime të caktuara duhen marrë parasysh nevojat praktike të organizimit të kontrolleve dhe konkurrenca ndërkombëtare; duke pasur parasysh se për këto raste specifike nevojiten dispozita të veçanta;

Duke pasur parasysh se transporti detar mund të përfshijë lloje të ndryshme udhëtimesh; duke pasur parasysh se, për raste të tilla transporti detar, nevojiten dispozita të veçanta;

Duke pasur parasysh se dispozitat e veçanta në fjalë duhet të zbatohen duke mos cenuar kontrollet e sigurisë;

Duke pasur parasysh se Shtetet Anëtare duhet të kenë mundësinë që të marrin masa të veçanta në pajtim me të drejtën Komunitare për kryerjen e kontrolleve të jashtëzakonshme, *inter alia*, për të parandaluar aktivitetet kriminale, veçanërisht që lidhen me terrorizmin, drogën dhe trafikimin e veprave të artit,

MIRATON KËTË RREGULLORE :

Neni 1

1. Bazuar në nenet 3, 4, dhe 5, nuk zbatohen kontrolle dhe as formalitete të çfarëdo lloji si:

- për bagazhet e dorës dhe bagazhet e regjistruara të personave që kryejnë fluturime brenda Komunitetit;
- për bagazhet e personave që kryejnë kalim detar brenda Komunitetit.

2. Kjo Rregullore zbatohet pa cenuar:

- kontrollet e sigurisë që kryhen për bagazhet nga ana e autoriteteve të Shteteve Anëtare, nga autoritetet portuale ose aeroportuale apo nga agjencitë e transportit;
- kontrollet që kanë të bëjnë me ndalime apo kufizime të përcaktuara nga Shtetet Anëtare, por që të jenë në pajtim me tre traktatet themeluese të Komuniteteve Evropiane.

Neni 2

Për qëllime të kësaj Rregulloreje:

1. "aeroport Komunitar" nënkupton çdo aeroport që ndodhet në territorin doganor të Komunitetit;
2. "aeroport Komunitar me karakter ndërkombëtar" nënkupton çdo aeroport Komunitar, i cili me autorizim të lëshuar nga autoritetet kompetente, është i miratuar për trafik ajror me vendet e treta;
3. "fluturim brenda Komunitetit" nënkupton fluturimin pa ndalesën e një mjeti fluturues midis dy aeroporteve Komunitare, i cili as niset dhe as përfundon në një aeroport jo Komunitar;
4. "port Komunitar" nënkupton çdo port detar që ndodhet në territorin doganor të Komunitetit;

5. "kalim detar brenda Komunitetit" nënkupton kalimin e kryer pa ndalesë mes dy aeroporteve Komunitare nga një anije që lidh rregullisht dy apo më shumë porte Komunitarë të përcaktuar;

6. "mjet lundrimi për argëtim" nënkupton barkat private të destinuara për udhëtime, itinerari i të cilave përcaktohet lirisht nga përdoruesit;

7. "mjete fluturuese turistike apo tregtare" nënkupton mjetet fluturuese private të destinuara për udhëtime, itinerari i të cilave përcaktohet lirisht nga përdoruesit.

Neni 3

Çdo kontroll dhe formalitet i zbatueshëm :

1. për bagazhet e dorës dhe bagazhet e regjistruara të personave që bëjnë fluturim në bordin e një mjeti fluturues i cili vjen nga një aeroport jo Komunitar dhe që pas një ndalesë të një aeroport Komunitar duhet të vazhdojë, fluturimin drejt një aeroporti tjetër Komunitar , duhet të kryhet në këtë aeroport të fundit, me kusht që ky të jetë aeroport Komunitar me karakter ndërkombëtar;

2. për bagazhet e dorës dhe bagazhet e regjistruara të personave që kryejnë fluturim në bordin e një mjeti fluturues i cili bën ndalesë në një aeroport Komunitar, para se të vazhdojë ky fluturim në destinacion të një aeroporti jo Komunitar, duhet të kryhet në aeroportin fillestar, me kusht që ky të jetë aeroport Komunitar me karakter ndërkombëtar;

3. bagazhet e personave që përdorin shërbim të kryer nga i njëjti mjet lundruar përfshi ndalesa të njëpasnjëshme nisjeje të cilat kanë filluar ose parashikojnë një ndalesë ,ose përfundojnë në një port jo Komunitar, të kryhet në portin në të cilin këto bagazhe në fjalë, sipas rastit, janë ngarkuar apo shkarkuar.

Neni 4

Çdo kontroll dhe formalitet i zbatueshëm për personat që udhëtojnë me:

1. mjete lundrimi për argëtim, pavarësisht nga vijnë apo destinacionit të këtyre mjeteve të lundrimi, kryhet në cilindo port Komunitar;

2. mjete fluturuese turistike ose tregtare, kryhet :

- në aeroportin e parë të mbërritjes , i cili duhet të jetë aeroport Kombëtar me karakter ndërkombëtar për fluturimet që vijnë nga një aeroport jo Komunitar ,nga ku mjetet fluturuese pas një ndalesë vazhdojnë fluturimin me destinacion të një aeroporti tjetër Komunitar;

- në aeroportin e fundit Komunitar me karakter ndërkombëtar për fluturimet që vijnë nga një aeroport Komunitar, nga i cili mjete fluturues pas një ndalese, vazhdon fluturimin me destinacion një aeroport jo Komunitar.

Neni 5

Me përjashtim të rasteve të veçanta që përcaktohen sipas procedurës së nenit 8, çdo kontroll dhe formalitet i zbatueshëm :

1) për bagazhet e regjistruara në bordin e një mjete fluturues që arrijnë në një aeroport Komunitar i cili vjen nga një aeroport jo Komunitar dhe i transportuar, në aeroportin Komunitar në fjalë, drejt një mjete fluturues tjetër që kryen fluturim brenda Komunitetit, kryhet në aeroportin e mbërritjes të fluturimit brenda Komunitetit, me kusht që ky të jetë aeroport Komunitar me karakter ndërkombëtar;

2) bagazhet e regjistruara të ngarkuara te një aeroport Komunitar për në një mjet fluturues që kryen fluturime brenda Komunitetit dhe që transportohen në një aeroport tjetër Komunitar te një mjet ajror me destinacion një aeroport jo Komunitar, kryhet në aeroportin e nisjes së fluturimit brenda Komunitetit, me kusht që ky të jetë aeroport Komunitar me karakter ndërkombëtar;

3) bagazhet që vijnë në një aeroport Komunitar me një mjet fluturues linje apo me një *charter* që vjen nga një aeroport jo Komunitar dhe transportohen, në aeroportin Komunitar në fjalë, te një mjet fluturues turistik apo tregtar që kryen fluturim brenda Komunitetit, kryhet në aeroportin e mbërritjes së mjetit fluturues të linjës apo të *charter-it* ;

4) bagazhet e ngarkuara në një aeroport Komunitar në një avion turistik apo tregtar që kryen fluturim brenda Komunitetit dhe që pastaj transportohen në një aeroport tjetër Komunitar për te një mjet fluturimi i linjës apo *charter* me destinacion një aeroport jo Komunitar, kryhet në aeroportin e nisjes së mjetit fluturues të linjës apo të *charter-it*.

Neni 6

1. Ngrihet një Komitet për lëvizjen e bagazheve të pasagjerëve ajrorë apo detarë (këtu e më poshtë referuar si "Komiteti"), i përbërë nga përfaqësues të Shteteve Anëtare dhe i kryesuar nga një përfaqësues i Komisionit.

2. Komiteti e harton vetë rregulloren e tij të brendshme.

Neni 7

Komiteti është i aftw për ekzaminimin e çfarëdo çështjeje që lidhet qenësisht me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, e cila paraqitet nga Kryetari, me iniciativë të tij ose me kërkesë të një përfaqësuesi të një Shteti Anëtar.

Neni 8

1. Dispozitat e nevojshme për zbatimin e kësaj Rregulloreje miratohen në bazë të procedurave të parashikuara në paragrafët 2 dhe 3.

2. Përfaqësuesi i Komisionit i paraqet Komitetit draft të masash që duhen ndërmarrë. Komiteti dorëzon mendimin e tij mbi draftin brenda një afati kohor të cilin kryetari mund ta përcaktojë në varësi të emergjencës së çështjes në fjalë. Mendimi dorëzohet me shumicën e parashikuar nga neni 48, paragrafi 2 i Traktatit.

3. (a) Komisioni miraton masat e parashikuara nëse ato përputhen me mendimin e Komitetit.

(b). Në rast se masat e parashikuara nuk përputhen me mendimin e Komitetit ose në mungesë të një mendimi, Komisioni, pa vonesë, i paraqet Këshillit një propozim lidhur me masat që duhen ndërmarrë. Këshilli vendos me shumicë të cilësuar.

(c). Nëse Këshilli nuk ka vendosur brenda tre muajve, nga data kur i është paraqitur propozimi, Komisioni miraton masat e propozuara.

Neni 9

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e tretë pas datës së publikimit në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Evropiane.

Kjo Rregullore është e zbatueshme që nga 1 janari 1993

2. Para 1 tetorit 1992, Këshilli rishikon Rregulloren mbi bazën e relacionit (progres-raportit) të Komisionit, në lidhje me ecurinë e harmonizimit të dispozitave të nevojshme dhe që janë për zbatimin e duhur të kësaj Rregulloreje dhe veçanërisht ato, që lidhen me heqjen e kufizimeve për ndihmat fiskale në favor të udhëtarëve në trafikun brenda Komunitetit. Relacioni shoqërohet me propozime, nëse ka, për të cilat Këshilli shprehet me shumicë të cilësuar.

Kjo Rregullore është e detyrueshme në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme nga të gjitha Shtetet Anëtare.

Hartuar në Luksemburg, më 19 dhjetor 1991,

Për Këshillin

Presidenti

P. DANKERT

(1) GZ nr. C 212, 25.8.1990, fq. 8

- (2) GZ nr. C 106, 22.4.1991, fq. 80; dhe GZ nr. C 326, 16.12.1991.
- (3) GZ nr. C 60, 8.3.1991, fq. 12.